



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA KUSHTETUESE
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT**

Nr. 43/2022 (JR)
Nr. 43/ 6 regj.

Tiranë më 05.06.2025

**SHPALLJE
E
NJOFTIMIT PËR ZHVILLIMIN E GJYKIMIT TË ÇËSHTJES, NË SEANCË PUBLIKE**

Nëpërmjet kësaj shpallje, Kolegji i Posaçëm i Apelit, bazuar në nenin 65, pika 1 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, njofton subjektet pjesmarrës në proces, si dhe të gjithë personat e interesuar, se më datë 05.06.2025, gjatë shqyrtimit mbi bazë aktesh në dhomë këshillimi të çështjes me numër regjistri nr. 43/2022 (JR), datë 27.09.2022, për ankimin e subjektit të rivlerësimit Çlirim Sino kundër vendimit nr. 547 datë 06.07.2022 të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, trupi gjykues, bazuar në nenin 51, pika 1, shkronja “c” të ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar, vendosi kalimin e çështjes në seancë gjyqësore publike, duke e ftuar subjektin e rivlerësimit që t’i përgjigjet pyetjeve që do t’i drejtojë trupi gjykues.

Seanca gjyqësore publike do të zhvillohet në **datën 16.06.2025 ora 10:00**, në selinë e Kolegjit të Posaçëm të Apelit, në adresën Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, nr. 3, Tiranë.

Trupi Gjykues, përbëhet nga gjyqtarët:

Kryesuese e Trupit Gjykues
Relatore e çështjes
Gjyqtar
Gjyqtare
Gjyqtare

Albana Shtylla
Rezarta Schuetz
Sokol Çomo
Ina Rama
Mimoza Tasi

Bazuar në nenin 460, pika 5 e Kodit të Procedurës Civile dhe nenin 51, pika 2 të ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar, kjo shpallje bëhet të paktën 10 ditë para seancës gjyqësore, në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelit dhe në ambientet e Këshillit të Lartë të Prokurorisë. Ky njoftim bëhet gjithashtu edhe në faqen e internetit të Kolegjit të Posaçëm të Apelit si dhe me njoftim individual në adresën elektronike alternative të subjektit të rivlerësimit.

KRYESUESE E TRUPIT GJYKUES
GJYQTARE

ALBANA SHTYLLA


